

VENDIM
Nr. 37, datë 18.1.2017

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I NËNSTACIONIT 110/20 KV GJIRI I LALËZIT, DURRËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 dhe 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i nënstacionit 110/20 kV Gjiri i Lalëzit, Durrës, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.
2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a.
3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, me vlerë totale të shpronësimit prej 152 567.1 (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë një) lekësh.
4. Vlera totale e shpronësimit prej 152 567.1 (njëqind e pesëdhjetë e dy mijë e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë pikë një) lekësh dhe vlera e shpenzimeve procedurale të përballohen nga fondet e Operatorit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a., si subjekti kërkues i këtij shpronësimi.
5. Shpronësimi të fillojë brenda muajit janar 2017.
6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundimin e procesit të kalimit të pronësisë, të pasurive të shpronësuara, në favor të OSHEE sh.a.
7. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, Operatori i Shpërndarjes së Energjisë Elektrike (OSHEE) sh.a. dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR INTERES PUBLIK, PËR NDËRTIMIN E NËNSTACIONIT
110/20 KV GJIRI I LALZIT DURRËS, FSHATI KURATEN, NJËSIA ADMINISTRATIVE ISHËM

Nr.	Pronari	ZK	Nr. Pasurisë	Lloji	Sipërfaqja	Çmimi	Vlera	Shënime
1	Thoma Çuni	2332	242/2	Arë	384.3	397	152 567.1	Konfirmim nga ZVRPP-ja
2	Shtet	2332	242/1	Kullote	3615.7			Konfirmim nga ZVRPP-ja